



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2024:115898

Datë: 28.05.2024

Numri i dokumentit: 05743036

**2024:115899**

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA KAÇANIK**, Departamenti I Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtarja Zajrete Muhaxheri me pjesëmarrjen e bashkpunëtorit profesional ismajl Kuçi, në lëndën penale ndaj të pandehurit B.B nga fsh...-Kaçanik, i akuzuar për veprën penale, Vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj: PP.II.nr.358/24 te dt.05 Prill 2024, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, më datë 23 Maj 2024, në prezencë të Prokurorit të Shtetit, Besnik Nuredini, përfaqësuesit të të dëmtuarës me autorizim Q. S. dhe të pandehurit, me dt.27 Maj 2024 mori dhe shpalli, dhe të njejtën datë përpiloi këtë:

## A K T G J Y K I M

I pandehuri B.B nga fsh..., Komuna Kacanik i lindur më dt...nga i ati Z... dhe e ëma Sh..., e gjinisë D..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosoves, i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, me nr.personal:..

## ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 14 Tetor 2023, në fshatin ..., Komuna Ferizaj, saktësisht në shtëpinë e tij, me qëllim të përvetësimit të sendeve të huaja të luajtshme, e që vetit t'i sjellë përfitim pasuror të kundërligjshëm, ka siguruar shërbime për të cilat e ka ditur se mundësohen vetëm me

shkëmbim të kompenzimit, në atë mënyrë që gjatë një kontrolli të njësorit elektrik me numër ...nga zyrtarët e KEDS-it, është konstatuar se njehsori elektrik ka qenë i shkyqur nga distanca për shkak të borgjit dhe është hasur në lidhje direkte jashtë pikës matëse në rrjetin elektrik, ashtu që energjia elektrike e shfrytëzuar nuk është regjistruar, me të cilin rast të dëmtuarës KEDS-Distrikti në Ferizaj i është shkaktuar dëm në vlerë prej j 67.52 €,

Me këtë veprim i pandehuri, ka kryer veprën penale, Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 të KPRK-së.

Prandaj gjykata, në bazë të nenit 2,7,38,48,69,70,71 par.1 nënpar.1.3 të KPRK-së, dhe nenit 358,359,360 dhe 364 të KPP-së, e

## **G J Y K O N**

Me dënim me kusht, me të cilin i vërtetohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 90 ditësh, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i pandehuri në afat prej një viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk do të kryejë vepër tjetër penale, në të kundërtën do t'i revokohet dënimi me kusht.

Detyrohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor, të paguajë pranë kësaj gjykate, shumën prej 20.00€, ndërsa për Fondin për Kompensimin e Viktimave të Krimit shumën prej 20.00€, në afat të njejtë me gjobën, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

Obligohet i pandehuri, që të dëmtuarës KEDS-Distrikti në Ferizaj, t'i kompenzojë dëmin në vlerë prej 67.52 €.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzen PP.II.nr.358/24 të dt.05 Prill 2024, të pandehurin B.B nga fsh...-Kaçanik, e ka akuzuar për veprën penale, Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 të KPRK-së.

Në bazë të kesaj aktakuze, gjykata ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin fillestar, me dt. 23 Maj 2024.

Prokurori I shtetit Besnik Nuredini ne fjalën e tij me rastin e prezentimit te aktakuzes , deklaroi se mbetet ne tërësi pranë aktakuzës se parashtruar me shkrim pranë kesaj gjykate.

Përfaqësuesi I të dëmtuarës, Q. S., në fjalën e tij në senacën e shqyrtimit fillestar, deklaroi se I bashkangjitet ndjekjes penale, dhe parashtron kërkesë pasurore juridike, në vlerën si në aktakuzë.

I pandehuri, në fjalën e tij në senacën e shqyrtimit fillestar, e ka pranuar fajësinë per veprën penale për të cilën e ngarkon aktakuza, duke shtuar se për shkak të pamundësisë për t'a paguar borgjin ndaj KEDS-it, I cili I ishte akumuluar, I është dashur që të lidhet në rrjetin elektrik, jashtë njehsorit elektrik, duke qenë se jeton në gjendje të dobët ekonomike. Megjithate I premtom gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisë këso veprime, meqë tani është në rregull me pagesat e faturave të rrymës, prandaj edhe I ka kërkuar gjykatës që të gjitha këto rrethana, të merren parasysh si rrethana lehtësuese dhe me rastin e marrjes së vendimit, t'I shqiptohet një denim sa më I ulët që të jetë e mundur.

Prokurori I shtetit ne fjalën e tij është dakorduar me pranimin e fajesisë nga ana e të pandehurit.

Gjykata ka konstatuar se janë përmbushur kushtet nga neni 242 par. 1 të KPRK-së, pasi që formoi bindjen se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajesisë, se pranimi i fajesisë është bërë vullnetarisht , se pranimi i fajit mbeshetet në faktet e çështjes që përmban akuza, se akti akuzues nuk përmban asnje shkelje te qartë ligjore apo gabime teknike, andaj me kete gjykata vertetoi gjendjen faktike si në dispozitivin e aktakuzës.

Nisur nga kjo gjendje e vërtetuar ne procedurë, gjykata gjeti se ne veprimet e te pandehurit manifestohen të gjitha tiparet e veprës penale, Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 të KPRK-së.

Me rastin e matjes dhe caktimit të dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese konform nenit 70 te KPRK-se, kështu qe si rrethane lehtësuese gjykata mori faktin se i pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkon aktakuza ne tërësi ne shqyrtimin fillestar, rrethanat në të cilat e ka kryer veprën penale, duke qenë se të njëjti i ishte akumuluar borgji dhe për shkak të gjendjes jo të mirë ekonomike, nuk ka mundur

që të kyqet në mënyrë të rregullt në rrjetin elektrik, ndërsa rrethanë të posaçme renduese gjykata gjeti se, i njeti bazuar ne evidencën penale te kësaj gjykate ka patur edhe disa raste të tjera penale të natyrës së njejtë, për të cilat është shpallur fajtor dhe dënuar me aktgjykim të formës së prerë.

Andaj gjykata, për këto arsye, të pandehurin B.B, i akuzuar për veprën penale Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 të KPRK-së, e gjykoi me dënim si ne dispozitiv, duke vlerësuar se dënimi i caktuar është ne proporcion me veprën si dhe sjelljen e të pandehurit, dhe se dënimi i shqiptuar është adekuat me intensitetin e rrezikimit te vlerave te mbrojtura, personalitetin e te pandehurit, andaj edhe konsideron se ky dënim do te ndikojë pozitivisht tek i pandehuri dhe personat tjerë qe te mos kryejnë vepra te tilla penale dhe se me këtë do të arrihet ne tërësi qëllimi i dënimit i paraparë ne nenin 38 te KPRK-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është i bazuar në dispozitën e nenit 449 të KPP-së.

Vendimi për taksën në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit është marrë konform nenit 36 par.3 nenpar.3.1 te Ligjit për Kompensimin e Viktimave te Krimit.

Vendimi për kërkesën pasurore jurididike, është i bazuar në dispozitën e nenit 462 par.2 të KPP-së.

Nga të cekurat e mësipërme u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi

## **GJYKATA THEMELORE FERIZAJ**

### **DEGA KAÇANIK**

**2024:115899 datë 27.05.2024**

Bashkpunëtori profesional,  
Ismajl Kuçi

Gjyqtarja,  
Zajrete Muhaxheri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mundet të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.